E hënë, 10 korrik 2023
[Seancë e hapur]
[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]
[I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]
--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithë.

Sot do fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04337, z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi janë të pranishëm në sallën e gjyqit. Ndërkohë që z. Krasniqi na ndjek përmes videolidhjes. Z. Krasniqi ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm këtu në sallën e gjyqit në pajtim me rregullin 96(2).

Përpara sesa të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit, më lejoni të sqaroj disa çështje organizative. Do të nxjerrim, së pari, një urdhër me gojë të lidhur me kërkesën urgjente të Mbrojtjes së Thaçit.

Më datë 3 korrik 2023, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një

kërkesë urgjente. Mbrojtja kërkon që ZPS-ja të japë një urdhër të paraqitjes së katër dëshmitarëve rezervë të identifikuar për muajin e korrikut.

Gjithashtu kërkohet në të që në fund të bllokut prej tre javësh të seancave të Gjykatës, pala thirrëse të japë njoftim sa i takon dëshmitarëve rezervë që synon që të thërrasë dhe të përcaktojmë më tej urdhrin e paraqitjes së dëshmitarëve këtu.

Më datën 5 korrik 2023, ZPS-ja u përgjigj përmes parashtrimit të protokolluar F01644. Ajo parashtron se Mbrojtja ka informacionin që është i nevojshëm për të përgatitur për dëshmitarët përkatës relevantë dhe nuk ka dhënë apo nuk ka demonstruar asnjë paragjykim.

Trupi Gjykues kujton se në pajtim ne paragrafët 74, 77, 80, të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor, ZPS-ja duhet të rendisë dëshmitarët në urdhrin tentativ në mënyrë që palët të dinë se cilët do të jenë dëshmitarët që do të thërriten. Në fund të këtij blloku prej tre javësh të seancave gjyqësore, pala thirrëse, dëshmitarët e palës thirrëse do të njoftojnë, pra, pala thirrëse do të njoftojë Trupi Gjykues dhe palët e tjetra si dhe pjesëmarrësit e tjetër dhe dëshmitarët të cilët synojnë që të thërriten për këtë bllok tre javor të seancave gjyqësore.

Trupi Gjykues së pari vëren se përmes njoftimeve të veta të dhëna më 21 qershor dhe 30 qershor, ZPS-ja është pajtuar si me Urdhrin e Zhvillimit të Procesit Gjyqësor si dhe urdhrit të

panelit të Trupit Gjykues të përcaktuar dhe të dhënë më datë 19 qershor. Mbrojtja, për pasojë, ka të gjithë informacionin që i nevojitet për t'u përgatitur për 12 dëshmitarët e radhës dhe për dëshmitarët e identifikuar si dëshmitarë rezervë.

Trupi Gjykues nuk është i bindur që është e nevojshme që të jepen detaje të tjera sa i takon dëshmitarëve rezervë për shkak të natyrës së këtyre dëshmitarëve. Paraqitja e tyre në seancën e Gjykatës varet nga faktorë të ndryshëm, si për shembull, orët që do të qëndrojmë në seancë gjyqësore, gjithashtu disponueshëmëria e dëshmitarëve dhe aspekte logjistike, të cilat e bëjnë të vështirë dhënien e specifikimeve të tilla.

Së treti, Trupi Gjykues pranon ndryshimet e momentit të fundit në kalendarin e dëshmitarëve dhe e di që kjo do të çojë në probleme për të gjithë, përfshirë këtu edhe Mbrojtjen. Të gjithë palët e përfshira pritet që të tregojnë një nivel fleksibiliteti për siguruar që këto procese gjyqësore do të zhvillohen pa vonesa të papërligjura.

Së fundi, nevoja për të thërritur dëshmitarë rezervë varet nga mënyra sesi shkon marrja në pyetje e drejtpërdrejtë nga Prokuroria dhe nga kundërpyetjet dhe jo nga dëshmitarët rezervë. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues thekson sesa më shumë informacion dhe vlerësime të sakta të kemi në kohën e duhur aq më mirë do të jetë.

Për këtë arsye, Trupi Gjykues kundërshton kërkesën e

Mbrojtjes në F01364.

Ky është fundi i urdhrit të parë gojor.

Tani sa i takon një sqarimi lidhur me dokumentin 1D20.

Më datë 20 qershor 2023, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi dokumentin SITF00032906, që është faqja e fundit e një dokumenti që e ka numrin e identifikimit më të gjerë ERN SITF00032906 deri në SITF00032918. Trupi Gjykues e ka pranuar dokumentin në tërësi dhe i ka caktuar numrin e provës materiale 1D29 dhe kjo jepet në transkript në faqen 5188.

Trupi Gjykues konsideron se pranimi i të gjithë dokumentit me numër identifikimi ERN në një faqe të vetme së pari e ofruar për pranim nga Mbrojtja e Thaçit. Dhe Trupi Gjykues konsideron që dokumenti duhet që të përmbushë, pra, i përmbush kriteret për pranim si i tërë në pajtim me rregullin 138.

Trupi Gjykues, për pasojë, qartëson që dokumenti 1D20 është dokumenti i mëparshëm ERN SITF00032906 deri në SITF00032918.

Ky është fundi i urdhrit të dytë gojarisht.

Të premten, ZPS-ja dha njoftim të synimeve të saj për të bërë kërkesë në bazë të rregullës 154 sa i takon Dëshmitarit 04746. ZPS-ja e fton Mbrojtjen të thotë në qoftë se synon që të kundërshtojë kërkesën e bërë.

Do t’i jap së pari fjalën Prokurorit që të shpjegojë kërkesën dhe pastaj do t’i jap Mbrojtjeve të të akuzuarve në

mënyrë që të shprehen lidhur me këtë çështje.

Z. Prokuror, e keni ju fjalën.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

Sikurse u përmend nga ju i nderuar Gjykatës, ZPS-ja njoftoi palët dhe pjesëmarrësit, në fakt, që më datë 7 korrik përmes postës elektronike që ne synojmë që të kërkojmë pranimin e dëshmisë së Dëshmitarit 4746 sipas rregullit 154.

Është e rëndësishme që të theksohet që nevoja për këtë kërkesë ka buruar vetëm nga pozicioni i qartë i parashtruar nga ky dëshmitar gjatë seancës përgatitore më datë 6 korrik, që është një javë më përpara. Në këtë seancë doli e qartë që në interes të drejtësisë do të ishte më mirë si dhe do të përdornim kohën më në mënyrë më efikase në Gjykatë në qoftë se do të parashtrohej dëshmia e dëshmitarit sipas rregullit 154. Dhe, sigurisht, kjo do të bëhet, në qoftë se respektohen të gjitha hapat proceduralë. Në qoftë se dëshmia e dëshmitarit do të pranohet në këtë mënyrë, ZPS-ja do ta ulën kohën e saj të marrjes në pyetje nga 12 në 6 orë.

Në postën elektronike të dërguar, gjithashtu juve përcaktuat edhe fushat e pyetjeve plotësuese dhe do të doja që ta sqaroja këtë çështje këtu. Mund të ndodhë që pyetjet shtesë të ulen më tej, pra, të ulen nga gjashtë orë, megjithatë kjo do të varet nga mënyra sesi do të shkojë pjesa e seancës së pyetjeve kryesore.

Sikurse përcaktohet në postën elektronike të dërguar për

ju, deklaratat e ofruara përmbushin kriteret sipas rregullit 154 dhe janë të përshtatshme për pranim në këtë mënyrë.

Shkurtimisht, ato trajtojnë strukturën e UÇK-së, rolin e dëshmitarit si komandant i zonës operative të Llapit, gjithashtu, përfshijnë edhe udhëzimet dhe urdhrat të cilat janë dhënë nga Shtabi i Përgjithshëm dhe krijimin e dhe mirëmbajtjen e ambienteve në zonën operative të Llapit.

Secila prej deklaratave të cilat ne kërkojmë që të pranohen sipas rregullës 154 ose janë bërë përpara një gjykate në kontekstin e proceseve gjyqësore në një gjykatë në Kosovës ose në mënyrë të drejtpërdrejtë të ZPS-së. Dhe këto deklarata janë të regjistruara audio dhe video me audioincizim dhe janë gjithashtu të pasqyruar në procesverbale. Dëshmitari është këshilluar për të drejtat e tij dhe është përfaqësuar nga avokati i vet në çdo rast. Të gjitha kriteret e zbatueshme në kuadrin e DHSK-së janë përmbushur në intervistat e kryera nga ZPS-ja.

Sikurse përmendet, gjatë seancës përgatitore javën që shkoi, dëshmitari konfirmon deklaratat që kërkon që të pranohet nga ZPS-ja, pasi i është dhënë atij mundësia që të rishikojë ato. Në lidhje me provat shoqëruese të cilat i kemi identifikuar në emailin që kemi dërguar ato janë përdorur dhe janë shpjeguar nga dëshmitari në deklaratat dhe përbëjnë pjesë përbërëse të tyre, ashtu siç përcaktohen te jurisprudencën përkatëse. Shkurtimisht, dokumentet janë kryesisht dokumente

të UÇK-së të lidhura drejtpërdrejti me rolin e dëshmitarit edhe fushat e tij të përgjegjësisë.

Ajo çfarë është e rëndësishme, i nderuar Gjykatës, nuk cenohet asnjë e drejtë e Mbrojtjes përmes pranimit të këtij dëshmitari në këtë mënyrë.

Së pari, Mbrojtja ka pasur njoftim goxha në kohë lidhur me dëshminë e këtij dëshmitari.

Së dyti, deklaratat në fjalë kanë qenë të disponueshme për Mbrojtjen për një periudhë të gjatë kohe, pjesa më e madhe e të cilëve i është bërë e ditur palëve në fund të vitit 2020 ose në fillim të vitit 2021.

Së treti, informacioni në deklarata në çdo rast mund të ishte nxjerrë ose konfirmuar përmes pyetjeve të drejtpërdrejta. Dhe përdorimi i rregullës 154 i jep mundësi Mbrojtjes që të kërkojë paraprakisht dëshminë në varësi të fushës së veprimit të dëshmisë.

Së katërti, dëshmitari do të jetë i pranishëm këtu në sallën e gjyqit dhe do të jetë i disponueshëm për pyetjet nga Mbrojtja, po gjithashtu edhe nga Trupi Gjykues. Po ashtu kjo në vetvete mjafton për të arritur në përfundimin që nuk ka cenim të Mbrojtjes.

Së fundi, pranimi do të çojë në uljen e kohës këtu në sallën e gjyqit. Dhe më lejoni të parashtroj, të nderuar Gjykatës, që kërkesa për zbatimin e rregullës 154 për këtë dëshmi nuk është bërë në kohë të vonuar. Ndoshta këto rrethana

janë të pazakonta, por megjithatë, sikurse e thashë edhe më përpara, këtë e bëjmë në mënyrë përjashtimore në interes të drejtësisë edhe sikurse e përmenda dhe më përpara, Mbrojtjet nuk cenohen në asnjë aspekt.

Këto janë parashtrimet e ZPS-së.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, z. Pace.

Z. Laws, keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me këtë çështje.

Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryesues i Seancës.

Ne jemi në kundërshtim të kësaj kërkese. Sepse është një kërkesë e cila bëhet gjashtë muaj me vonesë. Kjo jo vetëm që është në shkelje të Urdhrit për Zhvillimin e Procedurave, por sikurse mund ta keni parë edhe përmes një emaili të dërguar sot më përpara, pra, kjo është një kërkesë e cila vjen gjashtë muaj me vonesë dhe nuk përmbush kriteret e rregullës 154.

Ka mungesë konsistence në argumentet që sapo dëgjuam. Na u tha në mënyrë të vagullt që duke marrë parasysh pozicionin që ka marrë dëshmitari në seancën parapërgatitore, kjo në vetvete e ka ndryshuar pozicionin e ZPS-së. Dhe një prej faktorëve që duhet të merrni parasysh është që dëshmitari, pra, duhet të konfirmojë që ai është në pajtim me faktin që

dëshmia e tij të jetë sipas rregullës 154.

Pra, në qoftë se dëshmitari thotë që "Unë nuk kam thënë asgjë të ndryshme" në seancën përgatitore mbase kjo mund të ishte çudi për të gjithë ne. Fakti që dëshmitari në vetvete nuk dëshiron që të diskutojë gjëra të tjera përtej asaj çfarë ka thënë në deklaratë, kjo nuk do të thotë që deklarata të pranohet sipas rregullës 154.

Dhe ne nuk shohim, nuk identifikojmë dot logjikën se pse po ndodh kjo gjë ose pse kërkohet që deklarata të pranohet në këtë mënyrë. Ajo ça dëgjuam sot është që duke marrë parasysh atë çfarë na ka thënë dëshmitari në seancën përgatitore. Por nga ana tjetër seanca përgatitore ka si synim që të shikojë dëshmitari deklaratat e dhëna, të bëjë korrigjime, të sqarojë gjërat dhe kjo, në fakt, nuk ka ndodhur. Dhe duke marrë parasysh atë çfarë ka ndodhur në seancën përgatitore, kjo në vetvete është një faktor i arsyeshëm dhe i mjaftueshëm për të mos u pranuar kërkesa e ZPS-së sepse i takon që dëshmitari nuk ka bërë korrigjime dhe nuk ka bërë rishikimin e deklaratave të tij të më përparshme.

Ka dhe disa argumente të tjera të cilat dëshirojmë të parashtrojmë. Së pari, kjo është bërë në shkelje, ky është parashtrimi ynë, është parashtrim të cilin ne e kemi bërë të ditur sa i takon pozicionit të të akuzuarve dhe këtë në fakt e kemi bërë të qartë në dokumentin F01474 të 24 prillit 2023, faqja 4, poshtëshënimi 10.

Ky dëshmitar, këtij dëshmitari i është thënë si i dyshuar në intervistë që ai ka detyrimin që të thotë të vërtetën ose në të kundërtën mund të përballet me ndjekje penale për vetëinkriminim dhe ne parashtrojmë që mbi bazën e nenit 125 të Kodit Penal të Kosovës, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kjo është në kundërshtim me atë çfarë duhet t'i ishte thënë dëshmitarit.

Pra, nuk ka asnjë bazë në rregull apo në ligj për udhëzimin që i ka dhënë ZPS-ja dhe besojmë që kjo në vetvete është një faktor që ju, të nderuar Gjykatës, duhet ta merrni parasysh.

Ka libra të tërë të shkruar lidhur me procedurën penale të Kosovës dhe mënyrën sesa i kujdesshëm duhet të jetë Trupi Gjykues kur flitet për intervistimin e të dyshuarve, të personave të cilët janë të dyshuar që kanë marrë pjesë në të njëjtat krime që janë ngritur kundër të akuzuarve në rastin në fjalë në krahasim me deklaratën e dëshmitarit. Sepse dëshmitari detyrohet që të tregojë të vërtetën. Ndërkohë që një i dyshuar, sipas ligjit të Kosovës, nuk është i detyruar që të dalë dhe të thotë të vërtetën. Nëse jeni të interesuar mund t'ju citoj një libër që flet për këtë. Por, problemi me këtë është që i dyshuari mund të ketë një motiv për të mbrojtur veten në qoftë se merret në intervistë si i dyshuar. Dhe kjo është një arsye tjetër sepse duhet që të dëgjojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshminë e këtij dëshmitari.

Së treti, në qoftë se duhet që të jemi efikasë dhe nuk mendoj që ka ndonjë argument efikasiteti këtu për t'u bërë. Megjithatë, në qoftë se flasim për këtë pikë, efikasiteti dhe koha gjyqësore nuk do shkurtohet për dëshmitarë të cilët janë të nivelit të lartë. Pra, ne duhet të marrim gjithë kohën që na duhet të marrim në Gjykatë me dëshmitarë të këtij rangu. Kështu që ne parashtrojmë që do të kemi të bëjmë me efikasitet të kohës gjyqësore, në veçanti, në qoftë se për dëshmitarë të tillë, ne dëgjojmë dëshminë e tyre në sallën e gjyqit dhe të mos pranojmë dëshminë e tyre mbi bazën e rregullit 154.

Dëshmitarë të tillë, si dëshmitari janë dëshmitarë të cilët duhet që të japin dëshminë e tyre *viva voce*.

Së fundi, jemi në kundërshtim me argumentin për efikasitetin e kohës gjyqësore sepse kam një kalendar të plotë këtu. Dhe ky është një ndër problemet në qoftë se ti e merr një kërkesë të tillë pasdite të premten, pra, ndoshta kjo është arsyeja që pse Trupi Gjykues e ka vendosur afatin pesë muaj më përpara. Megjithatë, domethënë, kam një tabelë të të gjitha problemet dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjmë me problemet e pyetjeve të ZPS-së të dëshmitarit, domethënë, kam dokumente të tilla të cilat kanë të bëjnë me mënyrën jo të duhur të bërjes së pyetjes nga ZPS-ja si për shembull: interpretimit të gjërave që ai ka thënë. Për shembull, mund t'ju jap një shembull, një ilustrim në pjesën 4, në rreshtin 6, në faqen 6, atij i thuhet që ka dhënë dëshmi në intervistën

e vet që ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me Shtabin e Përgjithshëm. Dhe pastaj i është thënë që "Nuk e the këtë gjë. Po ke thënë që ke qenë në kontakt të vazhdueshëm me Shtabin e Përgjithshëm".

Por, në qoftë se shikojmë kontekstin, nuk del fare e qartë kjo, domethënë, në kuptimin që ai nuk ka thënë që ka qenë në kontakt të përgjithshëm, të vazhdueshëm, konstant, pra, me Shtabin e Përgjithshëm.

Këto janë çështje të cilat duhet që të trajtohen të gjitha në kundërpyetje prej nesh. Pra, në qoftë se ka ndonjë paqartësi për sa i takon mënyrës sesi janë bërë pyetjet apo mënyrën sesi janë dhënë përgjigjet nga dëshmitari, ne duhet të kemi të drejtën që t'ia bëjmë këtë pyetje dhe t'i sqarojmë gjërat në këtë Gjykatë. Prokuroria nuk dëshiron që t'i sqarojë të gjitha këto çështje me pyetjet e tyre të drejtpërdrejta dhe ia kalon barrën Mbrojtjeve duke u thënë Mbrojtjeve që ju bëni pyetjet tuaja dhe gjeni se çfarë donte të thoshte vërtetë dëshmitari dhe cilat janë paqartësitë në deklaratën e tyre.

Kjo nuk është fare puna jonë. E thashë edhe njëherë, që nuk ka arsye sepse një kërkesë e tillë të dërgohej të premten pasdite. Ne parashtrojmë që kjo është cenuese për Mbrojtjen.

Dhe ne parashtrojmë që kjo nuk është një kërkesë e cila përmbush kriteret e 154, në qoftë se do të ishte në përputhje me 154, atëherë do të duhej që të ishte bërë kërkesa që në fillim të shkurtit dhe jo vetëm para pak ditëve. Dhe mendojmë

që kërkesa është e vonuar dhe nuk ka shpjegime të qenësishme sepse një urdhër i tillë apo një kërkesë e tillë e ZPS-së duhet të pranohet nga Trupi Gjykues.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë për të thënë nga Mbrojtja e z. Veseli?

Z. STRONG: [Përkthim] Po, disa çështje për t'u ngritur për të mbështetur pozicionin tonë.

Mocioni sipas rregullës 154 përfshin deklarata të shumta të cilat janë parashtruar në tërësinë e tyre. Besoj që bëhet fjalë për nja 300 faqe material. Ky material në vetvete nuk është i qartë. Dëshmitari shpesh herë ballafaqohet me deklarata që janë kontradiktore, që nuk janë të qarta dhe si rezultat është përgjegjësia e Mbrojtjes që të sqarojë gjëra të cilat nuk janë të qarta dhe kjo është një punë të cilën ne duhet t'ia bëjmë përmes kundrapyetjeve, por kjo duhet mbështetet tek rrethanat që do të dalin nga marrja në pyetje e dëshmitarit nga ZPS-ja.

Na duhet më shumë kohë nga këndvështrimi ynë i Mbrojtjes. Këtë e kemi thënë edhe në emailin tonë. Por kursimi i kohës nuk do të jetë në ato dimensione që u parashtruan nga Prokuroria. Më lejoni të them që ne dëshirojmë që të dëgjohemi, sepse ne do të kërkojmë të paktën një ditë kohë në dispozicion, pra, një shtyrje seance prej një ditë të paktën në mënyrë që të riorganizohemi.

Gjëja e dytë që doja të theksoja është që fakti që kjo

doli në pah gjatë seancës përgatitore të dëshmitarit. Unë personalisht do të doja që të dëgjoja pak më tepër lidhur me interesat e drejtësisë që mbrohen këtu dhe që janë shkaqe për parashtrimin e kërkesës, më konkretisht dua që të shikoj dallimin ndërmjet kërkesës për të deklaruar, atëherë, për deklarimin e këtij dëshmitari si armiqësor. Pra, është e dukshme që kjo nuk ka ardhur si rezultat i seancës përgatitore. Megjithatë, në qoftë se do ta marrim parasysh këtë që tha Prokurori, ju lutem do të donim që të kishim më shumë hollësi lidhur me interesat e drejtësisë që i shërben kjo kërkesë, pra, shtyrja apo pranimi i deklaratës së dëshmitarit sipas rregullit 154.

Në mbështetje të asaj çfarë tha kolegu, pra, z. Misetic. Ne mendojmë që ky dëshmitar, pra, deklarata e këtij dëshmitari është unike dhe është problematike, do ishte problematike në qoftë se do të pranohej dëshmia e tij sipas rregullës 154. Dëshmitari është intervistuar si i dyshuar. Taktikat e intervistës janë absolutisht, domethënë, janë të tilla që mund të shërbejnë për të çuar në përfundime të ndryshme. Pra, ka shumë aspekte të cilat asnjëherë nuk duhet që të lejohen që të çojnë në pranimin e deklaratave të këtij lloj dëshmitari sipas rregullës 154.

Sa i takon shembullit që dha z. Misetic, ky është një shembull shumë i mirë, të nderuar Gjykatës. Kështu që, në qoftë se do shikojmë këtë seksion, që është i dhënë në një

faqe dhe në qoftë se, për shembull, do shikojmë dëshminë në dokumentin SPOE001193178 dhe do të doja që të shikojmë këtë krahasimisht me SPOE001193179 dhe të krahasojmë se çfarë ka dhënë dëshmitari si dëshmi në nivelin lokal dhe çfarë i ka dhënë ZPS-së.

Ne mendojmë që intervista e ZPS-së është një intervistë shumë e dobët dhe si rezultat nuk duhet që të pranohet sipas 154.

Këto janë parashtrimet tona.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Roberts.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Mbështes atë çfarë thanë kolegët e mi dhe nuk dua që të përsëris atë çfarë thanë kolegët. Megjithatë, një çështje dua ta ngre dhe ajo ka të bëjë diligjencën.

Nga perspektiva e Prokurorisë, kjo është intervistë e cila është zhvilluar katër vite më përpara. Dhe ka një kohë të gjatë ndërhyrjeje kur mund të ishin bërë, domethënë, diskutime të mëtejshme ose kërkesa të tjera dhe mund të kishin konstatuar mënyrën sesi të merreshin me dëshmitarin në fjalë. Por, ZPS-ja nuk e bëri punën e vetë. Priti vetëm tre ose katër ditë përpara sesa të vendoste përfundimisht sesi do ta trajtonte dëshminë e dëshmitari. Të nderuar Gjykatës, me respekt ju them që kjo nuk mendoj se kjo ka qenë aksidentale.

Ky është një pozicion i ZPS-së që do që ta bëjë punën të

përfunduar, domethënë, do që t'ju detyrojë ju, të nderuar Gjykatës, që ta pranoni dëshminë e dëshmitarit sipas kërkesës së ZPS-së. Pra, kjo nuk është fare, kjo nuk është në përputhje me diligjencën në emër të Prokurorisë.

Në qoftë se do të marrim parasysh intervistën dhe llojin e dëshmitarit, kjo në vetvete demonstron pse na duhen, pse na nevojiten pesë muaj. Nuk është një afat që është thjesht formalist. Nuk është thjesht për arsye administrative ose programimi. Por është për arsyen se duhet që të kemi të drejtën që të bëjmë parashtrime thelbësore të kemi kohën e përshtatshme dhe të nevojshme në qoftë se ZPS-ja kërkon pranimin e dëshmisë sipas rregullit 154 dhe ju, të nderuar Gjykatës, duhet të keni kohën e nevojshme për të shqyrtuar këtë dëshmi po ashtu.

Domethënë, të detyrosh palët që bëhet pranimi i dëshmisë në momentin e fundin nuk është mënyra sesi duhet të procedohet më tej.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Ellis.

Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për arsyet që u dhanë nga kolegët, neve, së pari, duam të themi që parashtrimi është bërë shumë me vonesë. Sepse, pra, sido që ta marrim, sido që ta trajtojmë këtë çështje prapë parashtrimi i Prokurorisë në vetvete është bërë me vonesë.

Dhe është problematik sepse afatet sikurse e tha kolegu kanë arsyet e veta. Një ndër arsyet është që t'ju lejohen

palëve që të shtjellojnë siç duhet problemet ose çështjet që mund të dalin nga rregulla 154, përfshirë këtu edhe kërkesat të cilat bëhen paraprakisht.

ZPS-ja u ngrit dhe tha që nuk ka cenim të Mbrojtjes, ndërkohë që ka bërë kërkesën në orën 4.00 pasdite, i tregon Mbrojtjeve në orën 4.00 pasdite, të premten që po ndryshon natyrën e parashtrimeve dhe unë mendoj që kjo është e papranueshme. Sigurisht, që ka dëmtim, ka cenim prej nesh.

Ne kemi javë, për mos me thënë muaj, që po përgatitemi që ky dëshmitar të vijë këtu dhe të jap dëshminë e vet *viva voce*. Materialet me shkrim mund të përdoren në kundërpyetjen e këtij dëshmitari. Ndërkohë që tani na thuhet që dokumentet me shkrim do jetë prova ose do jetë dëshmia e këtij dëshmitari, kështu që e gjithë puna që ne kemi bërë ka shkuar dëm.

Dhe kjo në vetvete çon në një tjetërsim të gjithë qasjes së Mbrojtjes. Dhe, sigurisht, në qoftë se ti e bën këtë gjë në momentin e fundit kjo është paragjykuese, është cenuese. Na u tha, gjithashtu, të premten që janë nja 60 faqe të përgjimeve të cilat Prokuroria dëshiron që të përdorë me këtë dëshmitar. Pra, të ndryshosh natyrën e dëshmisë të kërkosh dhe 60 faqe të tjera që të përdorësh pa diskutim që kjo na ngarkon me barrë të tepërt ne si Mbrojtje, gjë e cila nuk është e drejtë për neve.

Të nderuar Gjykatës, sikurse e dini, rregulli 154 është në dorë të Trupit Gjykues për të vendosur apo jo. Nuk është e

drejtë e Prokurorisë. Kështu ju, të nderuar Gjykatës, duhet që të gjeni një baraspeshë ndërmjet asaj çfarë ofrohet si plus përmes pranimit të parashtrimeve në këtë mënyrë.

Ne nuk pranojmë që në qoftë se do kursejmë gjashtë orë, atëherë kemi të bëjmë me një efikasitet shumë të madh të seancës gjyqësore. Sepse kjo vjen me një kosto. Pjesë e kostos është pranimi i 300 faqeve, faqe të cilat shpeshherë, domethënë, nuk janë në konsistencë me njëra-tjetrën. Dhe sikurse e thashë kjo nuk është e drejtë e ZPS-së, vendosja ose vendimi duhet të merret nga Trupi Gjykues. Dhe në qoftë se ne do kursejmë kohë sot kjo kohë do të na duhet ta zëvendësojmë me shumë kohë të tjera në të ardhmen.

Dhe përveç kësaj, sikurse e thashë më përpara, ne si Mbrojtje jemi përgatitur për të bërë kundërpyetjet mbështetur në atë çfarë i ka thënë dëshmitari Prokurorisë. Por, në qoftë se kemi ndryshim të barrës së provës atëherë do jetë shumë e vështirë për neve që të identifikojmë mungesën e konsistencës dhe problemeve që ekzistojnë në dëshminë e dëshmitarit. Kjo nuk është e thënë që do jetë e pamundur për neve, por do jetë shumë herë më e vështirë për neve dhe do të na duhet shumë herë më tepër kohë. Kështu që unë nuk e pranoj parashtrimin e ZPS-së që do të kursehen gjashtë orë.

Por nga ana tjetër, do thosha që këto nuk janë dëshmi që janë të përshtatshme për t’u pranuar sipas rregullës 154 për shkak të rëndësisë së tyre. Të nderuar Gjykatës, ju këtë e

keni njohur në vendimin e parë për pranimin e provave materiale sipas rregullit 154, paragrafi 28 të parashtrim të protokolluar 1380. Ju aty, të nderuar Gjykatës, thoni që rëndësia e provës materiale të propozuar është një prej faktorëve që duhet të merret parasysh në momentin kur vendoset për pranimin e dëshmisë sipas rregullit 154 ose në qoftë se vendoset që dëshmitari të japë dëshminë e vetë *viva voce*. Ne mendojmë që ky është shembulli i qartë në të cilin ju duhet që ta zbatoni këtë rregull të përcaktuar prej jush.

Pra, këtu keni një dëshmitar që është në nivelin e komandantit të zonës, që është një prej dëshmitarëve të paktë në atë hierarki nga ZPS-ja, është përmendur 30 herë, të paktën 30 herë në dosjen paraprake të Prokurorisë. Intervista e të cilit, po ashtu, kërkon që ajo si parim, domethënë, që dëgjohet përmes dëshmisë *viva voce* ose me gojë të dëshmitarit e jo sipas 154. Së dyti, dëshmitari është marrë në pyetje si i dyshuar; së dyti natyra e intervistës në fjalë kërkon që të merret dëshmia e këtij personi në mënyrë të drejtpërdrejtë në sallën e gjyqit dhe për shkak të rëndësisë së dëshmisë së tij.

Të nderuar Gjykatës, ka edhe parashtrime të tjera të hollësishme që kanë të bëjnë me provat materiale të shoqëruara, por mbase nuk është çasti i përshtatshëm ky për t'u futur në hollësi të tilla.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

Do t'ju jap fjalën z. Pace.

Por unë kam një pyetje. Pikë së pari, do të doja të trajtoni se çfarë ka ndodhur konkretisht gjatë seancës përgatitore që papritmas futi në lojë këtë aplikimin e parimit të interesit të drejtësisë të cilin ju po e parashtroni sot këtu.

Z. PACE: [Përkthim] Çdo gjë që ndodhi gjatë seancës përgatitore gjenden në shënimin përkatës. Shkurtimisht, ajo që ndodhi është kjo, dëshmitari i rishikoi materialet e veta, ju dha mundësia të vinte të na thoshte nëse kishte ndonjë ndryshim, sqarim apo shtesë. Tha që nuk kishte dhe konfirmoi saktësinë e tyre.

Pastaj ne, si Prokurori, i bëmë pyetje, dëshmitari tha që nuk ishte gati të fliste për këtë gjatë seancës përgatitore dhe, në fakt, u pajtua t'i përgjigjej disa pyetjeve të thjeshta që thjesht reflektojnë shënimin.

Kjo tregon që dëshmitari, në një rast tjetër, thjesht konfirmoi dëshmitë që ka dhënë më përpara. Interesi i drejtësisë është ky, lidhet me argumente sa i takon efikasitetit të procedurave gjyqësore, nuk është e nevojshme që ky dëshmitar të vijë fizikisht këtu, të përsërisë të njëjtat informacione identike për gjashtë orë a më shumë, kur shumë qartë i ka konfirmuar atë që ka thënë. Interesi i drejtësisë është që të pranohet thjesht informacioni që ka dhënë.

Dhe sa i takon parashtrimeve të Mbrojtjes, fillimisht do të flas për argumentin lidhur me natyrën e përshtatshme apo të papërshtatshme të intervistës së Prokurorisë. Neni 125(3) i Kodit Penal të Kosovës i referohet të pandehurve. Më konkretisht është përfshirë dhe në Rregulloren e Procedurave të Gjykatës dhe është shumë e qartë. Nuk ka nevojë ta shtjellojmë shumë në thellësi këtë.

Dëshmitari nuk ka qenë nën betim kur ka dhënë intervistën, kështu që nuk bëhet asnjë shkelje edhe sikur të gjenim nenin përkatës të rregullores së Kodit të Penal.

Dëshmitari ka pasur avokat mbrojtës gjatë intervistës dhe kështu ndodh me të dyshuarit dhe u informua për të drejtën për të qëndruar i heshtur, prandaj nuk pati asnjë cenim të të drejtave të këtij personi.

Për çdo rast, siç e përmenda disa herë, dëshmitari thjesht konfirmoi deklaratat e veta gjatë seancës përgatitore dhe e njëjta gjë do të ndodhte nën betim në qoftë se do të miratohej kërkesa nga Trupi Gjykues. Kjo është një parakusht për pranimin. Ai thjesht duhet të vërtetojë ato që ka thënë.

Prandaj, nuk ka pasur asnjë shkelje të Kodit Penal dhe në qoftë se do të kishte ndodhur kjo, do të bëhej një hetim sipas rregullës 138 dhe ne themi që nuk ka ndodhur asgjë këtu për të futur në lojë këtë nen. Sigurisht, nuk është dëmtuar vërtetësia apo nuk është vënë në dyshim vërtetësia e këtij dëshmitari.

Sa i takon kohës shtesë që kërkon Mbrojtja, ne mendojmë, është që duke qenë se kemi një dëshmi të madhe të këtij dëshmitari do ta bëj më të lehtë punën Mbrojtjes kur të bëjë pyetjet. Dhe, të nderuar Gjykatës, sikurse dëgjuat nga parashtrimet, njësoj si ne, mbase dhe ju s'e kuptoni, pse qenka e vështirë të pranosh 300 faqe materiale, pse është më e vështirë për ta, ndërkohë që duhet të ishte më e thjeshtë në fakt për të pranuar këtë material dhe për të bërë kundërpyetjet e veta. Sepse kur përgatit kundërpyetjet, sikurse bëj dhe prokurorët, sigurisht që e gjithë puna bëhet në bazë të dëshmive që ka dhënë përpara dëshmitari. Sepse ne nuk e dimë çfarë do ketë dëshmitari në sallën e gjyqit.

E vetmja gjë që ka ndodhur është që dëshmitari ka pranuar dhe ka konfirmuar këto 300 faqe, prandaj Mbrojtja është tërësisht në pozicion që të përgatisë kundërpyetjet. Nuk ka asgjë kontradiktore në qëndrimin tonë. Nuk i është bërë asnjë cenim Mbrojtjes. Dëshmitari i konfirmoi, nuk bëri asnjë korrigjim. Madje tha, konkretisht, nuk kam asgjë për të korrigjuar. Mbrojtja ngriti disa probleme që burojnë prej këtyre deklaratave. Është e drejta e tyre, sigurisht, që ta bëjnë këtë.

Ne, sigurisht, do të bëjmë disa pyetje shtesë. Po nëse ata nuk pajtohen me deklaratat, konkretisht, me deklaratat e ZPS-së, sikurse e theksuam, është qëllimisht, është sigurisht detyra e tyre që t'i sqarojnë të gjitha paqartësitë kur të

bëjnë kundërpyetjet. Sa i takon, nuk e mbaj mend formulimin si e thanë konkretisht, po sa i takon deklaratave apo veprimeve të paqarta nga Prokuroria, keni zbardhjen e të gjitha procesverbaleve, çdo gjë pyetje-përgjigje i keni në materiale të zbardhura. Kështu që gjë mund të rishikohet atje. Prandaj s'kishte asgjë të vagullt në këto deklarata.

Sa i takon diligjencës. Nuk po fshihemi, nuk po themi që s'ka ndodhur. Mund ta kishim bërë më përpara, por mungonte një diçka e rëndësishme që është seanca përgatitore. Fakti që dëshmitari thotë "Unë i konfirmoj të gjitha gjërat që kam thënë, po s'dua t'u përgjigjem pyetjeve tuaja", i ndryshon rrethanat. Pikërisht, pra, për shkak të atyre që sapo shpjegova, fakti që Mbrojtja i ka pasur dokument për vite, t'i shqyrtojnë, t'i analizojnë, nuk u cenon kjo aspak përgatitjen e pyetjeve.

Nuk shohim asnjë arsye për shtyrje të seancave. Nëse do të bëhet një shtyrje e seancave, mendojmë që duhet të bëhet pasi të pranohet materiali si provë.

Z. STRONG: [Përkthim] Kërkojmë ndjesë. Z. Veseli nuk mund të ndjekë procesin ka një problem teknik më duket, nuk po merr materialin. Nuk po merr informacion, sinjal.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Veseli, a dëgjoni?

Z. STRONG: [Përkthim] Besoj se dëgjon po sheh transkriptin në ekran. Ka një problem teknik. Më duket se ky

është problemi. Dhe po përpiqet Sekretarja që ta zgjidhë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doni të prisni apo doni të vazhdojmë?

Z. STRONG: [Përkthim] Mendoj që në qoftë se është e mundshme të presim pak, por po shoh nga Sekretarja e Gjykatës të më thotë sa kohë nevojitet për ta zgjidhur këtë problem teknik.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht që ne duam që z. Veseli ta lexojë dhe transkriptin.

Z. Misetic, kishit diçka për të thënë?

Z. MISETIC: [Përkthim] Doni të thoni të ndalojmë për një çast që të zgjidhim problemin teknik? Ju kërkoj ndjesë, mendoj që ju keqkuptova. Mendova se donit të bënit një pushim të shkurtër për të zgjidhur problemin teknik.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

Do të flasim edhe për parashtrimet tuaja.

Do të bëjmë një pushim të shkurtër sa të zgjidhet problemi teknik. Thjesht qëndroni këtu afër mos u largoni. Bëjmë një ndërprerje të shkurtër për disa minuta derisa të zgjidhet problemi teknik.

--- Pauza fillon në orën 09.45

--- Seanca rifillon në orën 09.45

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, mbaroni.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Dua thjesht të falënderoj gjykatën në emër të z. Veseli që mundësuan këtë zgjidhje teknike në mënyrë që edhe ai t'a ndjekë procesin në mënyrën e duhur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Vazhdoni, z. Pace.

Z. PACE: [Përkthim] Në fakt po flisja për kërkesën e Mbrojtjes për një shtyrje. Ne nuk gjykojmë se është nevoja. Sidoqoftë, Trupi Gjykues le t'i dëgjojë parashtrimet vetëm në qoftë se miratohet kërkesa sipas rregullës 154. Edhe, aktualisht, është thjesht spekulim për ne që të kërkojmë një shtyrje apo jo, sidoqoftë, e thashë dhe më herët, bazuar në arsyet që u parashtruan, ne nuk e gjykojmë të nevojshme.

Sa u takon parashtrimeve të Mbrojtjes së Selimit për qëndrimin e Mbrojtjes që paska qenë strategjike edhe "për ta detyruar" Trupin Gjykues që ta pranonte këtë kërkesë. Kjo është thjesht spekulative, është e pabazë. Ju garantojmë që vendimi ynë u bë në vijim të seancës përgatitore që unë përmenda edhe rregulla 154 nuk u përzgjodhe më herët për këtë dëshmitar sepse ne nuk prisnim që të ishte -- nuk menduam që ishte mënyra më e mirë për të përdorur kohën gjyqësore.

Në përmbyllje, përmendja tha se i takon Trupit Gjykues të vendosë. Sigurisht, ne mendojmë që Trupi Gjykues, sigurisht, që do të përdorë kompetencën e vetë për të pranuar apo për të autorizuar sipas rregullës 154. Gjithashtu, sa u takon

pranimit të deklaratave, kundrapyetjet e Mbrojtjes, pyetjet nga Gjykatësit, nuk ka dyshim që kjo është një mundësi e shkëlqyer që të eksplorohen më tej dëshmitë e dëshmitarit edhe t'i shërbejmë drejtësisë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Për t'iu kundërpërgjigjur.

Pikë së pari, ju bëtë një pyetje konkrete që është një thelb të kësaj çështjeje, çfarë ndodhë në seancat përgatitore.

Prokuroria tha, ai na tha që në një rast të mëtejshëm, se e ka bërë më përpara të njëjtën gjë, ai thjesht konfirmoi saktësinë e deklaratave të veta. Pra, po na thotë: Ne e dinim para seancës përgatitore që do t'i konfirmonte, se i ka konfirmuar dhe herë të tjera që i ka të sakta këto që ka thënë. Dhe ne u tronditëm kur zbuluam që e paska bërë të njëjtën gjë të premten.

Dhe ky është një ndryshim në rrethanat që na sollën në këtë diskutim që po bëjmë këtu. Duhet të ketë arsye më të forta, ka diçka, nuhasim diçka të dyshimtë në të gjithë këtë, vjen erë kjo punë.

Rregulla 154 [sipas përkthimit] këtu vlen, duhet të zbatohet. Mbase ka një problem përkthimi me fjalën "i pandehur" tek përkthimi në anglisht. Sepse ai nuk është i pandehur në një hetim, po është i dyshuar në një hetim. Nuk ka të pandehur në dyshim.

Gjykata nuk ka kompetencë të pavarur sipas ligjit që të

përndjek për betim për deklarata të rreme. Neni 15 dhe 16 i drejtohen Kodit Penal të Kosovës dhe i kërkojnë Gjykatës që të marrë parasysh Kodin Penal të Kosovës për të ndjekur penalisht dëshmitarin për deklaratë të rreme. Prandaj duhet parasysh Kodi Penal i Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale për të gjykuar çfarë është deklaratë e rreme, për çfarë duhen paralajmëruar dëshmitarët edhe çfarë ndodhë nëse dëshmitari nuk thotë të vërtetën dhe se duhet të ndiqet penalisht pastaj në bazë të Kodit Penal të Kosovës. Pra, këto janë.

Ne mendojmë që nëse do të shikojmë Kodin Penal të Kosovës, duhet të shohim çfarë është konkretisht deklarata e rreme dhe çfarë ndodhë kur jep deklarata të tilla.

Sa i takon cenimit që i është bërë Mbrojtjes. Ka kaq shumë problematika me këto intervista, paqartësi, pyetje sugjestionuese që u thanë edhe nga kolegët më përpara, të cilat nuk do dilnin gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta nga Prokuroria. Ne do ishim përgatitur për një seancë *viva voce*, ne do të kundërshtonim këtu në seancë *viva voce*. Trupi Gjykues do të kontrollonte dhe do të merrte vendimet përkatëse, por në këtë rast ajo që po ndodhë është na kanë kaluar barrën ne.

Ajo që duan të bëjnë është të pranohet i gjithë materiali thonë "Tani ju të Mbrojtjes, lexojini ato 300 faqe dhe ju kundërshtoni çdo pyetje që mendoni se ka qenë e papërshtatshme për dëshmitarin". Kjo kërkon kohë për t'u përgatitur dhe pastaj për të bërë kundërpyetjet.

Kaq kisha unë nga ana ime.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne nga ana e ekipit të Veselit, sigurisht, që synojmë që t'i bëjmë disa pyetje këtij dëshmitari.

Kundërpyetjet janë përgatitur mbështetur në faktin që do të ketë pyetje nga Prokuroria dhe bazuar në këto pyetje do të përgatiten kundërpyetjet. Tani po shohim që Mbrojtja e z. Thaçi, pra, pritet nga Mbrojtja e z. Thaçi t'i bëjë pyetjet kryesore, kështu e kuptojmë ne, pra, të bëjnë dhe pyetjet kryesore dhe kundërpyetjet e dëshmitarit.

Arsyeja pse ka rregulla dhe rregullore, sa i takon identifikimit në kohë të dëshmitarëve të rregullës 154, pra, kjo rregullore ekziston qëllimisht për të pasur mbarëvajtje dhe t'i shërbehet siç duhet drejtësisë. Kjo është një ndryshim shumë i madh, i cili nëse miratohet, e bën shumë të vështirë dhe s'ka më kuptim pastaj pse ka pasur një urdhër për zhvillimin e seancave gjyqësore. Dhe në qoftë se duam të respektojmë këtë rregullore, nuk mund të presim, pra, që të thonë të hënën që të përgatitemi ne për të martën për një ndryshim kaq radikal.

Ajo që më duket më shqetësuese, kur shoh z. Pace, ai se ju tha para një çasti që e vetmja gjë që ka ndodhur gjatë seancave përgatitore është që dëshmitari ka refuzuar t'i përgjigjet pyetjeve dhe thjesht ka konfirmuar deklaratat. Ai ka refuzuar t'u përgjigjet shumicës së pyetjes ku u është

përgjigjur vetëm dy pyetjeve. Edhe z. Pace nuk shikon asnjë ndryshim.

Pra, Prokuroria thotë që dëshmitari do të reagojë në Gjykatë në të njëjtën mënyrë siç do të sillet, pra, në Gjykatë në një mënyrë siç u soll gjatë seancave përgatitore. Kjo nuk është e drejtë sepse paragrafi 6 i rregullit për seancat përgatitore është që dëshmitari duhet t'u përgjigjet pyetjeve të Prokurorisë në sallën e gjyqit jo gjatë seancave përgatitore.

Pra, nuk ka asnjë bazë për kërkesën që ata po parashtrojnë, sepse Prokuroria nuk ka të qartë, nuk e di mbase çfarë përgjigjesh do të jepte dëshmitari për pyetjet konkrete që do t'i bënte Prokuroria në sallën e gjyqit.

Në paragrafin 11 të Urdhrit për Zhvillimin e Seancave Gjyqësore, Trupi Gjykues thotë që të mos ndjekim praktika dredharake. Ky ndryshim në taktikë nuk është i barazuar në rrethana të paparashikuara. Është ndryshim taktike sepse Prokuroria ka dashur të ndryshojë taktikën për ta përdorur në favorin e tyre. Nuk duan t'i bëjnë pyetje dëshmitarit, por duhet t'ia bëjmë ne.

Po me gjithë respektin, kjo nuk ka asnjë farë kuptimi, kjo ndryshon të gjithë bazën për mënyrën sesi zhvillohen seancat gjyqësore. Jo nuk është çështje diskrecioni këtu. Po do ishte tërësisht gabim që të pranohej një kërkesë e tillë e jo më të miratohej.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranoj më përgjigje dhe kundërpërgjigje. Po marr parasysh të gjitha parashtrimet që bëtë deri tani dhe do të marrim vendimin përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur.

Tani të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit W04337. Përpara se të sjellim dëshmitarin vërej se Prokuroria ka dhënë një përmbledhje të deklaratave të dëshmitarit në bazë të rregullës 154 më 30 qershor të cilat mund të lexohen në seancë të hapur.

Me sa kuptoj, nuk ka asnjë kundërshtim nga Mbrojtja sa i takon kësaj përmbledhjes.

Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi asnjë kundërshtim.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Asnjë kundërshtim.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Asnjë kundërshti.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Megjithatë unë kam disa kundërshtime sa u takon shënimeve përgatitore që ka dhënë Prokuroria. Unë thjesht po ju bëj me dije që unë kam kundërshtime. Mund ta bëjmë tani para se të vij dëshmitari apo mund ta diskutojmë pak më vonë?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Presim një çast, fillojmë me dëshmitarin, sepse ka kohë që po pret jashtë.

Trupi Gjykues i rishikoi përmbledhjen dhe mendojmë që kjo përmbledhje ndihmon që publiku të kuptojë seancën e ditës së sotme. Prandaj, është pranuar në bazë të rregullës 154, Trupi

Gjykues autorizon Prokurorinë që ta lexojë përmbledhjen e propozuar në seancë publike.

Sekretare, ju lutem sillni brenda në sallën e gjyqit dëshmitarin. Dhe do të qëndrojmë në seancë të hapur deri në momentin që do të përfundojë edhe leximin e betimit.

Z. Pace, ju doni të filloni në seancë të hapur?

Z. PACE: [Përkthim] Do të bëj një hyrje të shkurtër në seancë të hapur, po më pas do më duhet të flas për të dhënat identifikuese dhe do të doja të kalonim në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do kemi seanca të hapura atëherë?

Z. PACE: [Përkthim] Do të përpiqem të bëj të pamundurën në bazë të rregullës 154 që t'i bëjmë të gjitha parashtrimet apo pyetjet në seancë të hapura.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes, Dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirëmëngjesi, z. Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A më dëgjon? A e dëgjoni mirë përkthyesin?

DËSHMITARI: Po, ju lutem, i nderuar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja do t'ju japi një tekst, ku është deklarata solemne të cilën duhet ta lexoni në bazë të rregullës 145 nën 141(2) të Rregullores së Procedurave dhe Provave.

Ju lutem ngrihuni në këmbë. Lexoni me zë tekstin që keni përpara.

DËSHMITARI: Betim solemn sipas rregullës 141(2). I ndërgjegjshëm dhe e ndërgjegjshme për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të mshefë asgjë për të cilën kam dijeni. Faleminderit.

A ka tjetër?

DËSHMITARI: W04337

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptove atë që lexove?

DËSHMITARI: Po. Po, zotëri.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e pranoni?

DËSHMITARI: Absolut po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Uluni tani.

Dëshmitar, ne jemi gati të fillojmë me dëshminë tuaj. Sikurse e dini, fillimisht Prokuroria do ju bëjë pyetje. Kur të mbarojë Prokuroria, ka të drejtën Mbrojtja t'ju bëj pyetje dhe Trupi Gjykues po ashtu, kolegët e mi mund të kenë disa pyetje për ju.

Prokuroria parashikon tre orë për pyetjet e veta. Ekipet e Mbrojtjes mendoj se kanë nevojë për gjashtë orë e gjysëm. Ne shpresojmë që të gjitha palët të jenë të kujdesshëm me

përdorimin e kohës. Trupi Gjykues mund të lejojë edhe pyetje shtesë nëse përmbushen kushtet. Ka të ngjarë që dëshmia juaj të zgjasë dy ditë a dy ditë e gjysmë.

Dëshmitar, përpiquni të jepni përgjigje të shkurtra, të qarta. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni nga pala që ta përsërisë pyetjen ose thjesht thoni që nuk e kuptuat dhe ata do ta sqarojnë. Po ashtu na thoni ku e mbështesni njohurinë tuaj, faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të thoni diçka lidhur me korrigjimet që keni bërë për deklaratat tuaja, ju duhet të thoni për procesverbal që deklarata me shkrim është e korrigjuar nga ju dhe pasqyron saktësisht deklaratën tuaj.

Ju kujtoj të flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se të jepni përgjigjen, flisni ngadalë që të dhe përkthyesit të kenë mundësi t'ju ndjekin.

Gjatë kohës që do jepni dëshmi në sallën e gjyqit nuk duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj jashtë mureve të sallës së gjyqit. Në qoftë se një person ju bën pyetje jashtë kësaj Gjykate lidhur me dëshminë tuaj, na informoni menjëherë.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, keni fjalën.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

Pyetje nga Z. Pace:

Z. PACE: [Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Jemi takuar më herët. Por do prezantohem dhe njëherë. Jam James Pace, jam Prokuror i ZPS-së. Gjatë orëve në vijim do t'ju bëj disa pyetje.

Përpara sesa t'i Kryegjykatësit që të kalojmë në seancë private për të marrë ca informacione që kanë të bëjnë me identitetin tuaj, më lejoni të them, që sikurse jua kam shpjeguar në seancën përgatitore javën e shkuar, përpara sesa t'ju bëj -- më shumë sesa t'ju bëj pyetje për çdo çështje për të cilën ju keni informacion, mund të jetë e mundur që të pranohen disa deklarata të mëparshme tuajat dhe në mënyrë që të bëhet kjo gjë ka disa hapa proceduralë që do të duhen që të bëhen, të cilat do t'jua shpjegojë pasi të thoni sesi quheni.

Z. PACE: [Përkthim] Për këtë arsye, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues kërkojmë që të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofon i çaktivizuar]

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Dëshmitar edhe njëherë më lejoni t'ju them që jemi në seancë të hapur, kështu që publiku dëgjon atë çfarë do të thoni ju.

Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju kërkoj që paraqisni disa dokumente në ekran dhe asnjëri prej këtyre dokumenteve nuk është për t'ju transmetuar publikut.

Dokumenti i parë është dokumenti me numër identifikimi SITF00371832 deri në 00371861. Faqja është 371841.

Faleminderit. Ju lutem a mund të kaloni më poshtë në faqe. Shumë mirë.

PY. A e njihni nënshkrimin tuaj në këtë faqe?

PË. Po. Po, i nderuar Prokuror.

Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, nga i njëjti dokument, a mund të paraqisni faqen 0371844. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, a e njihni nënshkrimin tuaj në këtë faqe?

PË. Po, i nderuar.

Z. PACE: [Përkthim] Tani le të kalojmë në dokumentin tjetër. Dokumenti SITF00371132 deri në SITF00371135. Në faqen 371133, ju lutem. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, a e njihni nënshkrimin tuaj në këtë faqe?

PË. Po, z. Prokuror.

Z. PACE: [Përkthim] Le të shohim një tjetër dokument, numri identifikimi SITF00371128 deri në SITF00371131. Faqja është 371129, ju lutem.

PY. Dëshmitar e njihni nënshkrimin tuaj në këtë faqe?

PË. Po, i nderuar z. Prokuror.

Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, dëshiroj që të paraqisni dokumentin SITF00368586 deri në 00368609. Faqja e këtij dokumenti mjafton.

PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që të keni dhënë dëshmi në çështjen që jepet në këtë faqe që keni përpara në ekran në datën e specifikuar aty dhe a ju kujtohet kjo gjë, pra, që keni dhënë dëshmi në këtë proces gjyqësore?

PË. Po, i nderuar Prokuror.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj, nuk do t'i japë çdo datë, domethënë, për pranim dëshmitarit. Por thjesht dua t'ju them që nuk do japë data të tjera, nuk do bëj pyetje të tjera që kanë të bëjnë me datat.

Tani më lejoni të kaloj në dokumentin SITF00367735 deri në 00367763. Ju lutem paraqisni faqen e parë për këtë dokument.

PY. Dëshmitar, e njëjta pyetje edhe për këtë dokument, a ju kujtohet të keni dhënë dëshmi në çështjen që përmendet në fillim fare të dokumentit që keni përpara që keni përpara në atë datën që keni përsëri në fillim të faqes që keni përpara?

PË. Po, i nderuar Prokuror.

PY. Edhe dy dokumente të tjera besoj kanë mbetur ose tre.

Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë te dokumenti 0043618-TR-AT e Rishikuar, pjesa e parë.

PY. Dëshmitar, ky është një dokument i cili ka të bëjë me një takim që keni bërë me ZPS-në në vitin 2017. A ju kujtohet ky takim?

PË. Po, z. Prokuror.

Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem a mund të kalojmë tek 043612 deri në 617. Dhe ju lutem paraqisni faqen e parë të këtij dokumenti.

PY. Faleminderit. Edhe ky dokument ka të bëjë me një takim me ZPS-në, pra, takim që ka bërë dëshmitari me ZPS-në.

Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të kalojë në faqen e fundit të këtij dokumenti. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, a e njihni nënshkrimin tuaj në këtë faqe?

PË. Po, i nderuar Prokuror.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që ju është dhënë mundësia që të jepni sqarime lidhur me dokumentet që ju tregova më herët dhe dokumente të tjera, a ju kujtohet t’ju jetë dhënë kjo mundësi javën që shkoi?

PË. Po, z. Prokuror.

PY. A ju kujtohet që ju bëtë disa sqarime lidhur me këto deklarata të mëparshme?

PË. Po, zoti i nderuar Prokuror. Po.

PY. A ju kujtohet që këto sqarime dhe disa korrigjime dhe shtesa janë përfshirë në një shënim që ju lexua ju me zë?

PË. Po, i nderuar.

PY. Dhe duke marrë parasysh korrigjimet që keni dhënë në këtë shënim, informacioni që pasqyrohet në dokumente që ju tregova sot dhe dokumentet që kanë të bëjnë me dëshminë që keni dhënë në data të tjera ZPS-së, a është informacioni i saktë dhe a pasqyron njohuritë ashtu siç i dini ju ato?

PË. Po, i nderuar z. Prokuror, i saktë është.

PY. Duke marrë parasysh korrigjimet e bëra prej jush, dokumentet që përmenda sot edhe dokumentet të cilat

reflektojnë data të tjera në shënime, a reflektojnë në mënyrë, a pasqyrojnë në mënyrë të qartë dhe a reflektojnë, pasqyrojnë atë çfarë do të thoshit sot në qoftë se do t'ju bëheshin të njëjtat pyetje si në ato dokumente?

PË. Po, zoti i nderuar Prokuror.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të pranohen në prova në materiale deklaratat e mëparshme. Ndërkohë që ERN përkatëse janë përshkruar në parashtrimin e ZPS-së më 4 korrik 2023, pra, në emailin që kemi dërguar në këtë datë. Ato gjithashtu përshkruhen edhe në shtojcën 6 të F0162, sipas kërkesës së rregullës 154. Sikurse e kemi thënë edhe në email, dy nga këto dokumente nuk kërkojmë që të pranohen në prova materiale.

Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim me deklaratat siç janë, por kemi kundërshtim me shënimin e përgatitjes që do të kërkohet të pranohet si provë materiale nga ZPS-ja.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kundërshtohen.

Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do t'i caktohen numra të provave materiale këtyre dokumenteve.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Gjithashtu do të kërkoj pranim të njoftimit të përgatitjes, besoj që jepet në listën e dokumenteve për këtë dëshmitar me numrin 114125 deri në 114141.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

A mund ta bëjmë këtë diskutim pa praninë e dëshmitarit ose ndoshta t'i heqim dëgjueset dëshmitarit? Cilado mënyrë të jetë më e thjeshtë për ju.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, e nxjerrim dëshmitarin nga salla e gjyqit për disa çaste.

Dëshmitar, do të nxjerrim nga salla e gjyqit për disa minuta.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. E di që jemi në seancë publike për momentin, kështu që nuk do t'i përmend përmbajtjet e paragrafëve që kundërshtoj, por në qoftë se është e nevojshme mund të sqaroj më tej.

Ka dy paragrafë në këtë dokument prej 17 faqesh që është shënimi përgatitor me 17 faqe, që është goxha i gjatë. Pra, janë paragrafët 58 dhe 64 që ne kundërshtojmë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. ROBERTS: [Përkthim] Ne parashtrojmë që këto paragrafë shkojnë përtej sqarimit të deklaratave të mëparshme dhe japin informacion shtesë dhe pretendime shtesë në mënyrë të tërthortë dhe të drejtpërdrejtë kundër z. Selimi dhe si përkufizim nuk duhet që të përfshihen në shënimin përgatitor,

qëllimi kryesor i të cilit është që të sqarojë informacion ekzistues të mëhershëm sipas rregullës 154.

Këto informacione nuk janë dhënë në deklaratat e mëparshme dhe në dokumentet që kërkoi të pranoheshin në prova materiale nga ZPS-ja. Kështu që ne e kundërshtojmë pranimin e këtyre dy paragrafëve si pjesë e shënimit përgatitor.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I njëjti arsyetim vlen për të dy paragrafët?

Z. ROBERTS: [Përkthim] Po. Të njëjtin arsyetim kemi për të dy paragrafët. Gjithashtu kundërshtojmë pranimin e paragrafit 64 sepse nuk jepet asnjë njoftim.

Dhe për paragrafin 58, domethënë, ajo çfarë parashtrojmë ne është që nuk duhet të jetë fare pjesë e njoftimit përgatitor, por mund të lejohet që të trajtohet me gojë me marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë të dëshmitarit nga Prokuroria.

Ndërkohë që sa i takon paragrafit 64, ky është informacion tërësisht i ri nuk reflektohet asgjëkundi në deklaratat e mëparshme, është një informacion të cilin e kemi marrë vonë, e kemi marrë pasdite të shtunën dhe ajo ça është me e rëndësishme, nuk është fare informacion i cili reflektohet në dosjen përgatitore ose në përmbledhjen sipas rregullit 95(4) dhe nuk është pjesë e provave të Prokurorisë.

Kështu që ne parashtrojmë që Prokuroria nuk duhet të lejohet që ta përfshijë këtë informacion as në shënimin

përgatitor dhe as të marrë prova nga dëshmitari *viva voce* këtu në sallën e gjyqit lidhur me këtë informacion që parashtrohet në këtë paragraf.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurori.

Z. PACE: [Përkthim] Atëherë së pari më lejoni që t'i referohem paragrafit 96 të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor, që e bën të qartë që detyrimi për nxjerrjen e informacionit që lidhet me njoftimin përgatitor, njoftimi duhet që të përfshijë qartësime, ndryshime, korrigjime si dhe informacione të cilat jepen nga dëshmitari.

Më tej në këtë paragraf, thuhet që:

"Pala mund ... të kërkojë paraqitjen e deklaratës së dëshmitarit për pranimin si provë dhe shënimet të cilat ka bërë korrigjime dëshmitari ...".

Dhe këtë kemi bërë ne, të nderuar Gjykatës. Pra, ne kemi njoftimin përgatitor të dëshmitarit sipas rregullit 154 dhe kemi bërë, pra, korrigjimet përkatëse, ndërkohë që kemi dhe Njoftimin Përgatitor numër 2, që trajton çështje të tjera.

Tani më lejoni që t'i marr dy paragrafët njëri pas tjetrit, nuk e di në qoftë se keni pasur mundësi që të shikoni me hollësi paragrafët. Por në qoftë se i hedhim një sy paragrafit 58 dhe mbase është më e lehtë për të gjitha palët që të tregojmë këtë paragraf në ekran.

Atëhere, ERN është dokumenti 114125 deri në 114141. Edhe njëherë ky është dokument i cili nuk duhet të transmetohet për

publikun. Dhe për shkak të faktit që jemi në seancë të hapur nuk do të futem në hollësi.

Ju kërkoj ndjesë, znj. Sekretare, është faqja 12, paragrafi 58. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofon i çaktivizuar]

Z. PACE: [Përkthim] Atëherë marrim paragrafin 58. Paragrafin 58 e keni përpara ekranit. E thashë dhe më herët, që jemi në seancë të hapur dhe nuk do të futem në hollësi të këtij paragrafi. Megjithatë, të nderuar Gjykatës, ju mund ta shikoni shumë qartësisht, që informacioni në këtë paragraf rrjedh nga dy fragmente të deklaratave të mëparshme të dëshmitarit që janë pranuar më herët mbi bazën e rregullit 154 dhe ky është informacion shumë i vlefshëm që është dhënë.

Pra, dëshmitarit i janë dhënë dy fragmente të një dokumenti dhe ai ka dhënë sqarime lidhur me këto fragmente. Nuk ka asgjë këtu që përbën informacion shtesë. Dhe në masën që mund të quhet shtesë është informacion i cili lidhet shumë ngushtë me këto dy paragrafë që janë paraqitur dëshmitarit.

Nëse doni që të futem në më shumë hollës do të duhet që të kalojmë në seancë private dhe do të t'ju tregojë specifikisht se cilat janë këto dy pjesë që i kemi treguar dëshmitarit. Megjithatë, paraprakisht, më lejoni të them, që bëhet fjalë për dy fragmente ose pasazhe konkrete. Pyetjet janë lidhur me këto dy paragrafë ose pjesë konkrete dhe

përgjigjet kanë të bëjnë me këto fragmente ose pjesë që i janë treguar dëshmitarit.

Ky ishte sqarimi për paragrafin 58.

Tani le të kalojmë te paragrafi 64, që është paragrafi i dytë që kundërshtohet nga Mbrojtja, është në faqen 14 të të njëjtit dokument.

Për të thënë më shumë kontekst lidhur me atë çfarë parashikohet në këtë paragraf, sigurisht që duhet të lexoni paragrafin 63. Mund ta bëni tani ose më vonë, si të preferoni. Megjithatë edhe njëherë në këtë rast dëshmitari po fliste për një incident konkret. Sikurse kishte folur për një incident në deklaratën e mëparshme, por në këtë rast na dha më shumë informacion, siç e tha me të drejtë Mbrojtja, për z. Rexhep Selimi dhe ky informacion lidhet me incidentin që po përshkruhet këtu.

Ndërkohë që ky incident nuk është në deklaratën e mëparshme lidhet me atë çfarë na ka shpjeguar ai më përpara. Ndoshta në rastin e atij paragraf mund të shohim sesi ky mund të jetë ndryshe nga paragrafi më herët. Sepse paragrafi më herët ishte thjesht sqarim i drejtpërdrejtë. Ndërkohë që në këtë paragraf na jepet informacion shtesë mbi bazën e pyetjeve që i bëmë ne dëshmitarit.

Sa i takon pretendimit që nuk jemi njoftuar, të nderuar Gjykatës, ju e keni rrëzuar kërkesa të ngjashme më herët kështu që parashtrojmë që pavarësisht nga fakti që kjo nuk

është diçka që është pjesë e dosjes paraprake ose e aktakuzës, ky është informacion që është dhënë vullnetarisht nga dëshmitari. Kështu që nuk ka asnjë paragjykim për Mbrojtjen për sa i takon këtij incidenti të posaçëm që lidhet me një prej të akuzuarve.

Përsëri, domethënë, sa i takon hollësive - nuk do të jap hollësi sepse jeni në seancë të hapur – megjithatë është shumë e qartë nga ajo çfarë jepet në këtë paragraf që kjo është diçka që na e dha dëshmitari. Ne e konsiderojmë këtë të rëndësishëm. Nuk kemi të bëjmë me rast paragjykimi ose cenimi të Mbrojtjes.

Dhe në qoftë se ju, të nderuar Gjykatës, vendosni që paragrafi 64 nuk është i pranueshëm si pjesë e njoftimit përgatitor, në qoftë se do të më jepnit leje mund t'jua bëj këtë pyetje dëshmitarit edhe ky informacion mund t'i jepet dëshmitarit vetë më mënyrë të drejtpërdrejtë *viva voce* këtu në seancë përpara Gjykatës. Pra, varet nga juve sesi do të doni që vazhdoni. Megjithatë, sigurisht, që ne do respektojmë atë çka do vendosni ju, të nderuar Gjykatës.

Megjithatë asgjë që kemi bërë neve nuk është në shkelje të Urdhrit për Zhvillimin e Proceseve Gjyqësore. Pra, ne e kemi ndarë shënimet në dy pjesë dhe këtë e kemi bërë për një arsye. Edhe njëherë paragrafi 58 është shumë i qartë, është sqarim që ka të bëjë me dy paragrafë të mëparshëm në deklaratën e dëshmitarit. Ndërkohë që paragrafi 64 sërish ka

të bëjë me informacion që lidhet me atë çfarë ka thënë dëshmitari në deklaratën e tij të më hershme.

Ky është parashtrimi ynë.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, të nderuar Gjykatës. Prokuroria ka rënë në kontradiktë me atë çfarë po thotë tre ose katër herë gjatë parashtrimit të fundit, pra, ose informacioni nuk është shumë i rëndësishëm dhe si rezultat, pra, Prokuroria nuk duhet që ta përfshinte ose ishte shumë i rëndësishëm dhe si rezultat, domethënë, Prokuroria duhej që të na kishte njoftuar neve mbi bazën e rregullës 95(4).

Realiteti dhe fakti është që ne e kemi marrë këtë informacion shumë vonë. Në qoftë se Prokuroria mendonte me rëndësi këtë informacion duhet që të na e kishte dhënë këto njoftim më herët dhe duhet t'ia kishte nxjerrë dëshmitarit më herët.

Problemi që kemi ne, të nderuar Gjykatës, është që Prokuroria duket sikur përpiqet të shtojë informacion në njoftimet përgatitore dhe, në fakt, ky nuk është korrigjim. Pra, informacioni që jepet në paragrafin 64 nuk është korrigjim dhe pa diskutim që edhe emrat që janë përcaktuar në paragrafin 59 nuk janë korrigjime. Korrigjimet janë kur bëhet një gabim në shkrim ose një gabim në transkript. Këtë e kuptojmë ne përkufizimin e gabimit. Ky është informacion shtesë. Kështu që nuk ka mundësi që informacion i tillë të

mund të përfshihet në këtë lloj dokumenti, pra, në shënimet përgatitore.

Tani fakti që ne kemi pranim të deklaratës sipas rregullit 154 javë më përpara, ka një arsye për atë sepse neve na bëhet fakt në momentin e fundit diçka që ne nuk kemi pasur dijeni më përpara. Kështu që unë vazhdoj që të kem të njëjtin qëndrim që thashë dhe më përpara. Dhe fakt është që informacioni në paragrafin 58 mund të trajtohet gojarisht, por paragrafi 64 ne jemi tërësisht kundër kësaj.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje për ju z. Pace, në paragrafin 64 dhe kundërshtimi i z. Selimi, Mbrojtjes së z. Selimi sa i takon njoftimit.

Dua të jem i qartë, dua të jem i qartë në qoftë se ju, pra, Prokuroria, do të kërkoni që të mbështeteni në këtë provë si pjesë të provave tuaja kundër z. Selimi. Domethënë, me fjalë të tjera, ngjarje që përshkruhen në paragrafi 54 a parashtroni ju që ju do të mbështeteni në këtë informacion që jepet në 64 për të vërtetuar pozicionin tuaj kundër z. Selimi? Në qoftë se thoni po, kur i është njoftuar ky incident Mbrojtjes në mënyrë të tillë që Mbrojtja të ketë kohën e arsyeshme për përgatitje? Se me ç'kuptoj parashtrim i Mbrojtjes është që ato nuk kanë pasur kohë që të përgatiten për këtë gjë dhe nuk kanë pasur njoftim fare.

Z. PACE: [Përkthim] As ne nuk kemi pasur njoftim për këtë incident. Pra, ne na u dha ky informacioni nga dëshmitari. Nuk

është e pazakontë në sallën e gjyqit që ti i bën një pyetje dëshmitarit dhe informacioni që të jep është plus informacionit që të ka dhënë më përpara.

Njoftimi për Mbrojtjen është mënyra ose forma e përgjegjësisë penale për të cilën është akuzuar Rexhep Selimi. Ky informacion, pra, i jepet autoriteteve kështu që ne sigurisht që do të mbështetemi në këtë për aq kohë sa i autorizohet.

Megjithatë, autorizimi që ose të pranohet në letër, në dokument ose parashtrimi *viva voce* duhet që të vendosen nga Trupi Gjykues, sepse mendoj që në çdo rast Mbrojtja nuk cenohet. Sepse Mbrojtja mund të kërkojë udhëzime z. Selimi sot apo nesër. Mund të hetojë sa të dojë lidhur me këtë gjë dhe mund të aprovojë që ne e kemi gabim. Kështu që ne nuk shohim asnjë lloj çështje paragjykimi apo cenimi të të drejtave të Mbrojtjes.

Në përmbyllje, më lejoni të them që, kur dëshmitari jep informacion, nuk e censurojmë dot, nuk e redaktojmë dot informacionin që na jep dëshmitari. Dëshmitari na e dha informacionin, ne raportuam, është aty. Kështu që procedura është e qartë se çfarë duhet të bëjë Mbrojtja. Ne nuk po sugjerojmë që Mbrojtja nuk mund të bëjë pyetje lidhur me këtë dhe nuk mund të hetojë lidhur me këtë incident, sigurisht që mund t’i bëjnë këto gjëra Mbrojtja.

Pra edhe njëherë, më lejoni t’ju them, që nuk ka asgjë

paragjykuese ndaj Mbrojtjes në qoftë se pranohet paragrafi 64 ashtu siç është apo në qoftë se kërkohet dhënia e dëshmisë me gojë nga dëshmitari.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Roberts, duket që pretendon që ka një lloj abuzimi lidhur me atë çfarë keni hartuar në Njoftimin e Përgatitjes numër 1 dhe 2. Domethënë, ka dallim goxha ndërmjet Njoftimit për Përgatitje 1 dhe 2. Domethënë, çfarë keni për të thënë lidhur me këtë? Ku e keni paragrafin 64 në Shënimin e Përgatitjes 2?

Z. PACE: [Përkthim] Ne kemi Shënimin Përgatitor 2 që përmban shumë informacion dhe ne e shohim këtë informacion si jo të lidhur me rregullën 154, është informacion i veçantë. Do ta shikoni që një pjesë e mirë e informacionit sipas Njoftimit Përgatitor numër 2 unë do të kërkoj pak më pas që ky informacion të pranohet *viva voce*. Sërish në qoftë se do t'i kthehem Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor në të thuhet që:

"...çdo informacion që merret nga dëshmitari".

Pra, Mbrojtja tani pretendon abuzim nga ana jonë. Dhe sugjeron që ne e kemi bërë edhe më herët këtë gjë. Megjithatë kjo është hera e parë që unë dëgjoj një pretendim për abuzim për sa i takon informacionit që përfshijmë në shënimin përgatitor. Megjithatë, informacioni jepet aty, informacioni është i saktë, sepse ky është një informacion të cilin dëshmitari po e përmendte brenda kuadrit të deklaratës sipas

rregullës 154.

Pra, në qoftë se ju mendoni që ne kemi përfshirë këtu sepse menduam që e kishte vendin ishte më e përshtatshme që të përfshihej në paragrafi 64, megjithatë jemi të hapur edhe në opsionin që ju mund të vendosni që ta dëgjojmë dëshmitarin me zë lidhur me këtë paragraf në sallën e gjyqit.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë dua t'ju pyes në qoftë se ka ndonjë palë tjetër që ka diçka për të kundërshtuar.

Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të kundërshtuar lidhur me shënimin.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Asgjë as neve.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam gjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do presim deri në pushim e kafes në mënyrë të tillë që të kemi mundësi që të diskutojmë ndërmjet nesh Trupi Gjykues.

Z. Pace, për momentin anashkaloi ose shmangi këto dy paragrafë dhe thashë, pra, që do të mundohem që të vendosë në lidhje me këto paragrafë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ju lutem Sekretares të fusë përsëri në sallën e gjyqit dëshmitarin.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Z. Pace, mund të vazhdoni.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

Meqë janë pranuar deklaratat e mëparshme, unë do të lexoj përmbledhjen në seancë të hapur.

Dëshmia që ka dhënë Dëshmitari 04337 në deklaratën e mëparshme të pranuar nga Trupi Gjykues përfshin informacionin si në vijim.

Dëshmitari 04337 është shqiptar i Kosovës i cili, vitin në 1998, ishte një bujk. Në mes të gushtit e morën nga shtëpia ushtarët e UÇK-së dhe e mbajtën përreth një muaj të ndaluar. E morën në pyetje anëtarët e UÇK-së, përfshirë dhe sa i takon bashkëpunimit me Serbinë, u abuzua verbalisht dhe u kërcënua. U keqtrajtua dhe u rrahë disa herë nga pjesëtarë të UÇK-së.

Gjithashtu pa, vërejti dhe që u rrahën dhe të ndaluar të tjerë dhe ishin në kushte të dobëta.

Gjatë kohës që u mbajt në ndalim, Dëshmitari 04337 qëndroi në një dhomë pa dyshek dhe nuk i dhanë ushqim të mjaftueshëm. Nuk u trajtua nga pikëpamja mjekësore. Lëndimet që pësoi Dëshmitari 04337 për shkak të rrahjes dhe keqtrajtimit kanë ende ndikim në mirëqenien dhe shëndetin e tij.

I nderuar Gjykatës, tani do të doja të kalonim në seancë private për pyetjet e para sqaruese.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private.

Kjo është për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit.

Kështu, z. Pace?

Z. PACE: [Përkthim] Po. Kështu, i nderuar Gjykatës.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë bëjmë pushimin e paradites. Shihemi në orën 11.30. Seanca ndërpritet.

--- Pauza fillon në orën 11.02

--- Seanca rifillon në orën 11.37

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndërkohë që jemi në seancë të hapur Trupi Gjykues do të vendosë për rrëzimin e parashtrimit të Mbrojtës së Z. Selimi, për sa i takuan paragrafëve 58 dhe 64 të Shënimit Përgatitor për dëshmitarin 04337.

Mbrojtja e Selimit kundërshton për pranimin e këtyre paragrafëve në pajtim të rregullit 154 mbi bazën që përbën çështje thelbësore më tepër sesa sqarime të një çështjeje tjetër të mëparshme. Sa i takon paragrafit 64 Mbrojtja e Selimit shton se ajo nuk ka marrë njoftim të përshtatshëm për rëndësinë e incidentit që pretendohet që të ketë ndodhur nga dëshmitari.

ZPS-ja parashtron që Shënimi Përgatitor është në përputhje me Urdhrin e Trupit Gjykues për Zhvillimin e Proceseve Gjyqësore dhe përbën sqarim të deklaratave të mëhershme të dëshmitarit. Kështu që duhet që të pranohet mbi bazën e rregullit 154.

Trupi Gjykues vendos si më poshtë: Paragrafi 58 përbën sqarime të lidhura me informacionet më të hershme të dhëna nga dëshmitar. Fakti që dëshmitari shton hollësi lidhur me dëshmitë e dhëna më herët nuk përbën arsye për të mos u përfshirë në deklaratën e tij dhe si rezultat, paragrafi 58 mund të pranohet, së bashku me pjesën tjetër të shënimit përgatitor, sipas rregullit 154.

Lidhur me paragrafin 64, Trupi Gjykues pajtohet me parashtrimin e Mbrojtjes që informacioni që përfshin paragrafi 64 është i ri. Trupi Gjykues gjithashtu pranon që incidenti i përshkruar në këtë paragraf nuk është i përmendur në aktakuzë; nuk është i përmendur në dosjen paraprake të ZPS-së dhe nuk është përmendur më herët në deklaratat e dëshmitarit 04337.

Mbi këtë bazë Trupi Gjykues arrin në përfundimin që z. Selimi nuk është i akuzuar konkretisht lidhur me incidentin e përshkruar në paragrafin 64.

Si rezultat, prova nuk do të pranohet për këto qëllime. Nga ana tjetër ky informacion përbën provë për faktin dhe vlefshmërinë që ngrihet në aktakuzë. Asnjë prej individëve të përmendur në paragrafin 64 nuk pretendohet që të kenë kryer krime për të cilat mund të mbajë përgjegjësi penale i akuzuari. Mund të përbëjë prova të cilat janë të rëndësishme për të përcaktuar autoritetin *de jure* apo *de facto* të z. Selimi.

Për rrjedhojë, Trupi Gjykues është i përgatitur që ta lejojë ZPS-në që ta përdorë këtë provë materiale për këtë qëllim të kufizuar.

Në të njëjtën kohë kjo provë e propozuar është provë e re për të cilën Mbrojtja nuk ka pasur njoftim të mëhershëm. Si rezultat, ky dokument duhet të ishte pranuar mbi bazën e rregullit 154. Në qoftë se ZPS-ja dëshiron që ta nxjerrë këtë informacion do të duhet që ta nxjerrë në mënyrë gojore nga

dëshmitari. Në qoftë se Mbrojtja e z. Selimi merr informacionin përkatës lidhur me këtë çështje mund të kryejë hetime të mëtejshme dhe mund të të rithërrasë këtë dëshmitar për ta marrë në pyetje lidhur me këtë çështje konkrete.

Ky është fundi i urdhrit gojarisht i Trupit Gjykues.

Znj. Sekretare, mund ta sillni në sallën e gjyqit dëshmitarin.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni gati, Dëshmitar?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po, i nderuar z. Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Pace, fjala për ju.

Ju kujtoj që jemi në seancë publike.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Do ju kërkoja që të kalojmë në seancë private në mënyrë të tillë që të mund vazhdojmë me të njëjtin linjë pyetjesh që filluam që të bënim përpara seancës të pushimit dhe arsyeja është që nuk duam që të nxjerrim informacion identifikues.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për këtë arsye i kërkoj Sekretares që të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë të hapur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Vazhdoni z. Pace. Keni rreth 5 minuta në dispozicion.

Z. PACE: [Përkthim] Në rregull.
PY. Dëshmitar, në seancë private, neve folëm lidhur me ndalimin tuaj. Nuk do e them vendin se ku. A mund të na thoni se në qoftë se gjatë ose pas këtij ndalimi ndonjë pjesëtar i UÇK-së ju dha mundësinë që të kundërshtonit faktin që ishin i ndaluar?
PË. Asnjëherë.
PY. Gjatë ose pas ndalimit, a ju dha ndonjë pjesëtar i UÇK-së ndonjë dokument që pretendonte që kjo ishte baza pse ju kishin ndaluar juve, që pretendonte që ju kishit bërë diçka keq edhe për këtë arsye ju ndaluan?
PË. Jo, kurrë s’më kanë dhënë kurrfarë dokumenti.
PY. Gjatë ose pas ndalimit tuaj, ndonjë pjesëtar i UÇK-së a ju ka akuzuar konkretisht për ndonjë krim që pretendohej që të kishit kryer ju atëherë?
PË. Jo, asnjëherë.
PY. Gjatë apo pas ndalimit tuaj, a ka pasur ndonjë pjesëtar të UÇK-së që ju ka akuzuar për ndonjë krim konkret që pretendohet që të keni kryer ju?
PË. Jo, zotëri Prokuror. Kërrkujt s’i kam pas borxh, asnjëherë.
PY. Për të qenë i qartë, e kam fjalën, kur flas domethënë, a ju kanë akuzuar, a ju kanë akuzuar zyrtarisht në mënyrë zyrtare për ndonjë krim që keni kryer juve, që pretendohet që të keni kryer?

PË. Mas [REDAKTUAR] nuk më kujtohet që më kanë maltretu më. Fjalë ka pas, por jo. Pyetja, përgjigja është jo tek unë.
PY. Dëshmitar, ju kujtoj që jemi në seancë të hapur. Nuk është e nevojshme të jepni kaq shumë shpjegime. Megjithatë, do ta heqim këtë informacionin që sapo thatë që ishte identifikues.
Përmendët, na thatë, pra, lidhur me ndalimin tuaj. A ju kujtohet në qoftë se ndonjë pjesëtar i UÇK-së, gjatë apo pas atij ndalimi ju ka dënuar zyrtarisht me ndonjë ndëshkim konkret?
PË. Jo, kurrë. Jo mas, jo, jo.
PY. Me aq sa dini ju, ndonjë pjesëtar i UÇK-së a ka, a është hetuar nga UÇK-ja, lidhur me ndalimin dhe keqtrajtimin tuaj?
PË. Jo një, por shumë. Shumë janë burgos e, jemi në gjyq me ta. [REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
PY. Do ju ndërpres këtu, Dëshmitar. Me aq sa dini ju, a ka ndonjë pjesëtar të UÇK-së që ka hetuar atë çfarë ju ka ndodhur juve, domethënë, a ka pasur ndonjë hetim UÇK-ja, lidhur me atë çfarë ju ka ngjarë juve
PË. Jo, s-- UÇK-ja, UÇK-ja s’ka pas mo çka me hetu. Jo.
PY. Dhe në fund, për momentin, me aq sa dini ju UÇK-ja a ka ndëshkuar ndonjë pjesëtar të UÇK-së lidhur me atë çfarë ju ka ngjarë juve, pra, UÇK-ja a ka ndëshkuar ndonjë ushtar të UÇK-

së lidhur me çfarë ju ka ngjarë juve?
PË. Ka qenë një ushtar i UÇK-së, ka qenë me mu në burg aty. A po pyet mbas luftës, z. Prokuror apo mbas lufte apo në luftë, në burg?
PY. Do ta sqaroj unë. Më dëgjoni, Dëshmitar, gjatë apo pas luftës a ke dëgjuar ndonjëherë që UÇK-ja të ketë hetuar apo të ketë akuzuar apo të ketë ndëshkuar ndonjë ushtar të UÇK-së lidhur me atë çfarë të ndodhi ty, po apo jo?
PË. Gjatë luftës, gjatë luftës, në burg kanë qenë disa me LDK-në, [REDAKTUAR] ai ka qenë ushtar me mua aty në burg. Po, edhe ka qenë i plagun, s'po më kujtohet, më fal se, më ka lëshu memoria, më kujtohet [REDAKTUAR] ushtar aty i plagun.
PY. Do t'ju ndërpres këtu.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më duket sikur ky është momenti më i përshtatshëm që ta ndërpresim seancën. Pas pushimit të drekës do më duhen maksimumi 10 minuta që të përfundoj me pyetjet për dëshmitarin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, z. Pace.

Dëshmitar, keni pushim tani për një orë e gjysmë. Keni pushimin e drekës. Do të kthehemi përsëri në sallën e gjyqit në orën 14.30. Ju lutem, mos flisni me askënd pas, përtej sallës së gjyqit lidhur me dëshminë tuaj.
PË. Faleminderit për këshillën.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pikë së pari, ka disa çështje që kërkojnë vendim.

Trupi Gjykues pranon dy faqet e materialit me ERN 098615 deri në 098616. Vetëm dy faqet e para të këtij materiali do të pranohen. Po ashtu do të pranojmë edhe Komunikatën Nr. 35. Të dy këto materiale i përmbushin kriteret sipas rregullës 138.

Trupi Gjykues po ashtu do të vendosë sa i takon kërkesës së Prokurorisë për pranimin e dëshmive të 04746 në zbatim të Rregullës 154.

I dëgjuam parashtrimet e palëve më herët gjatë ditës së sotme lidhur me këtë aspekt. Edhe në kuadër të kërkesës së Prokurorisë ne iu referuam ndër të tjera refuzimit të dëshmitarit 04746 për t'iu përgjigjur pyetjeve shtesë gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë. Për të kursyer kohën dhe për të mos cenuar mbrojtjen, Prokuroria parashtron se janë përmbushur kushtet e Rregullës 154 në këtë rast.

Mbrojtja bëri me dije se i kundërshton parashtrimin dhe kërkesën e Prokurorisë duke theksuar në veçanti natyrën e vonë të këtij aplikimi dhe mënyrën si cenon përgatitjen e Mbrojtjes sepse kërkon ndryshim në qasjen e tyre.

Trupi Gjykues vendos kështu. Së pari Prokuroria nuk ka paraqitur arsye të mjaftueshme që përbëjnë arsye të vlefshme për t'u pajtuar me afatin e 7 shkurtit për të cilin kishte vendosur Trupi Gjykues në bazë të rregullës 154, sa i takon 12 dëshmitarëve të parë. Dhe kjo është në transkriptin e 18 janarit në faqen 1902.

Së dyti, Trupi Gjykues pajtohet me Mbrojtjen se ndryshimi në mënyrë e prezantimit të provave të dëshmisë së 04746 do të cenonte në fakt të pandehurin.

Së treti, në kuadër të rëndësisë së dëshmisë së propozuar, Trupi Gjykues vlerëson se arsyet duhet të ishin paraqitur paraprakisht me shkrim. Të tilla arsye nuk janë paraqitur.

Prandaj, Trupi Gjykues rrëzon kërkesën e Prokurorisë për të pranuar dëshminë e dëshmitarit 04746 në bazë të rregullës 154.

Me kaq mbyll edhe urdhrin me gojë.

Sekretare, mund të sillni tashmë dëshmitarin në sallën e gjyqit.

Z. PACE: [Përkthim] Kam nevojë të sqaroj diçka lidhur me materialin e parë që keni pranuar.

Faqen që i treguam dëshmitarit besoj që janë dhe faqet që pranuat, janë faqja 098615 dhe më pas 098619.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ju kërkoj ndjesë, ka qenë gabimi im. Sekretare, ju lutem bëni

ndryshimin e nevojshëm në numrat e faqeve që janë pranuar.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në faqen 95 rreshti 1, del emri "Veseli" në transkript. Mendojmë që është një gabim. A mund ta sqarojmë me dëshmitarin për cilin person e kishte fjalën kur e përmendi këtë emër? Dhe këtë mund ta bëjmë në momentin që dëshmitari vjen në sallën e gjyqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëjë z. Pace, mund ta bëni dhe ju kur të bëni pyetjet tuaja.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Më lejoni t'u jap numrat përkatës materialeve. Atëherë, materiali me numër 098615 dhe 098619 do të marrë numrin e Provës materiale P222 [sipas përkthimit].

Dhe Komunikata 35 do të marrë, dhe përkthimi bashkë, do të marrin numrin e Provës materiale P221.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, dëgjoni?

DËSHMITARI: Po, ju lutem, po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Prokuroria ka edhe disa pyetje të tjera dhe do të fillojnë tani.

Mund të vazhdoni z. Pace. Z. Pace, doni të qëndrojmë në seancë publike?

Z. PACE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Do ju lutesha të kalojmë në seancë private. Kam nevojë

dhe për pesë ose dhjetë minuta kohë. Dhe arsyeja për seancë private është mbrojtja e identitetit të dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Do të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, mund të shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

Faleminderit, Dëshmitar për dëshminë tuaj sot. Mos harroni që nuk duhet të diskutoni me askënd lidhur me dëshminë tuaj.

DËSHMITARI: Faleminderit prej juve. Jeni të nderum të gjithë. Ditën e mirë.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca ndërpritet këtu, shihemi nesër në orën 9.00.

--- Seanca mbyllet në orën 16.02